

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-26-6898-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material për zyre**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH OFFICE TRADE

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Rexhep Malaj nr.25

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

049/589845

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Arbnora Aliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Officetrade2002@yahoo.com

(Adresa elektronike)



24.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Dosja e tenderit është me date : 18.08.2026
Kriteret e Dhënies : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët
Hapja e tenderit është parapare me date : 24.08.2026 ora 14:00
Kerkesen për info shtese : 20.08.2026 ora 09:16
Kërkesa për rishqyrtim : 22.08.2026
Sqarimet për info shtese : 24.08.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 24.08.2026
Ankesa ne OSHP : 24.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

HAPJA E TENDERIT ESHTË PARAPARE TË BEHET ME DATEN 24.08.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 22.08.2026, bazuar në nenin 108/A të LPP-se, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-se, kundër vendimit për njoftim të kontratës ku janë prezantuar prova dëshmi dhe fakte me të cilat është konfirmuar shkeljet që janë bërë nga AK-se në këtë aktivitet të prokurimit, megjithatë AK – **MINISTRIA E PUNEVE TË BRENDSHME**, përsëri konsumon shkelje ligjore dhe refuzon kërkesën tonë si jashtëafatshme pavarësisht faktit se asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk i trajton fare dhe nuk ofron asnjë argument apo baze ligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1 Qellimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore

Neni 37 Mostrat e Tenderëve

Neni 19 Specifikimet Teknike

Gjate vlersimit të këtij aktiviteti AK ka vepruar në kundërshtim edhe me RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) gjegjësisht nenet si vijon

Neni 19 i Rregullores së prokurimit publik - Specifikimet Teknike.

Neni 37 Mostrat e Tenderëve

Afatet Kohore

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne si OE i interesuar për pjesëmarrjen në këtë aktiviteti të prokurimit me datë 19.08.2026 kemi shkarkuar dosjen e tenderit të publikuar nga AK.

Me shqyrtimin e dosjes së tenderit – specifikimit teknik AK-ja ka vepruar në kundërshtim të plote me Ligjin e prokurimit publik dhe legjislacionin sekondar për prokurim publik në Republikën e Kosovës.

Menjëherë me datën 20.08.2025 ne mbështetje të nenit Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore kemi kërkuar sqarime shtese për persona i përfshirë në pozicioneve të paqarta dhe kemi kërkuar sqarime dhe nuk kemi pranuar asnjë informate shtesë dhe ne mbështetje të nenit 108/A ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim duke i ofruar faktet dhe argumentet tona se AK me veprimet e ndërmarra ka vepruar në kundërshtim të plote me LPP-në dhe legjislacionin sekondar njëhërti duke mos i respektuar as kërkesat të cilat vet i ka specifikuar. Ndërsa me datën 24.08.2026 ne ditën e hapjes së procedurës 4 ore para hapjes pranojmë sqarimet shtese dhe me datën 24.08.2026 pranojmë vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK –, ku në atë vendim shihet qartë se ne asnjërin prej pretendimeve tona nuk ofrohet përgjigje apo arsyetim se pretendimet tona nuk qëndrojnë.

Nga përgjigja e AK-se shihet qartë se veprimet e tyre janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim të plote me Ligjin e prokurimit publik dhe legjislacionin sekondar.

Edhe përkundër faktit se ne kemi ofruar prova dhe dëshmi të mjaftueshme për shkeljet që kanë ndodhur gjatë përgaditjes së këtij aktiviteti megjithatë AK këto prova gjegjësisht pretendimet tona ankimore fare nuk i trajton dhe refuzon kërkesën si të pa bazuar, prandaj në kuptim të nenit 109 të LPP-se në afatin e paraparë paraqesim këtë:

ANKESE

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, ne mbështetje të nenit 109 të LPP-se paraqesim këtë ankesë kundër njoftimit për kontratë të AK-se për aktivitetin e prokurimit të lartcekur, me arsyetimin se:
Autoriteti kontraktues gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme gjatë përgaditjes së këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje dhe nuk ka vepruar në harmoni me
: Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Me këto veprime AK ka vepruar në kundërshtim të plote me nenin 1 Qëllimi të LPP-se gjegjësisht pikës 1 të këtij neni i cili e specifikon saktë se:

Pretendimi 1

Neni 1 Qëllimi

- 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*
- 2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Shihet qarte qe qellimi i kesaj procedure nuk eshte qe fondet publike te shfrytezohen ne menyre transparente dhe te drejt pasi qe kjo procedure eshte bere ne menyre identike me proceduren e vitit te kaluar ku eshte ritenderuar tri(3) here deri sa fitues ka dal operatori ekonomik i caktuar.

Pretendimi 2 Me veprimet e ndërmarra AK për këtë aktivitet te prokurimit ka vepruar ne kundërshtim me nenin Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti gjegjësisht pikës 1 te këtij neni:

- 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Pretendimi 3

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

- 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
- 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.*
- 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.*

Ne kete procedure gjithacka ka vetem barazi ne trajtim dhe jo diskriminim nuk ka. Jane kerkuar disa mostra te cilat jane jashte standardeve te shtypit , mostra te cilat jane jashte percaktimit te dimezimeve, jane shpikur dimezime vetem e vetem qe te mos mund krijohen keto mostra.

Neni 7 pika 2 thot qe AK nuk nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik dhe ne kete rast kerkesa per te sjell mostra te ndryshme jashta standardeve redukton konkurencen dhe ben qe mos te kete pjesemarrje ne kete aktivitet.

Pretendimi 4

Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore

- 24.1 Një OE, mund të kërkojë, me shkrim, informata shtesë sqaruese për dokumentet e tenderit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik – vetëm nëpërmjet funksionit të dedikuar për kërkesa për sqarime.
- 24.2 Një kërkesë e tillë me shkrim duhet të dërgohet përmes funksionit “sqarimet e DT” në platformën elektronike dhe duhet të pranohet nga AK brenda afatit kohor të specifikuar në DT. Nëse kërkesa për sqarime pranohet pas ditës së fundit të paraparë për sqarime në DT, kërkesa e tillë refuzohet dhe OE do të informohet për arsyen e refuzimit. Një kërkesë e dorëzuar pas afatit të paraparë për sqarime mund të shqyrtohet dhe nëse konsiderohet se është në interes të AK, e njëjta mund të pranohet.

Ne me daten 20.08.2026 ne ora 09:16 kemi ngarkuar kerkesen per sqarime, per informata shtese per disa artikuj dhe nuk kemi pranuar asnje informate sqaruse dhe konfrom ligjit te prokurimit eshte dashur qe te ngarkohen sqarime shtese, duke u bazuar edhe ne ate qe e kane cekur vetem qe sqarimet jane deri me daten 20.08.2026 ne ora 12:00 e jo deri ne fund te orarit te punes sic e parasheh ligji .

Ndersa me datën 24.08.2026 ne ora 09:37 , katër (4) ore para hapjes se procedures AK-ja kthen sqarimet e kërkuara dhe njofton se te gjitha mostrat duhet te jene me llogo ku AK nuk ka ngarkuar as llogon e instutcionit se si duhet te jete llogo ndërsa hapja e procedurës eshte me datën 24:08.2026 ne ora 14 :00 dhe si eshte e mundur qe te shtypen gjithë ato mostra me llogo mbrena nje afati kaq te shkurtër.

Gjithashtu AK-ja ngarkon ne sistemin e -prokurimi sqarimet me datën 24.08.2026 , ndërsa datën ne dokument e vendos 20.08.2026 dhe me kete rast dëshiron qe te na vendos ne lajthitje dhe te beje mashtrim kinse i ka dërguar sqarimet me datën 20.08.2026

Pretendimi 5

Neni 19 Specifikimet Teknike

- 19.2 Nëse është e aplikueshme, AK do të specifikoj në njoftim të kontratës specifikimet e tilla teknike ose do të ofroj deklarata të qarta që tregojnë ku mund të merren specifikimet e tilla teknike.
- 19.3 Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, përformanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.
- 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara

Pikerisht eshte neni 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta,sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ne kete procedure ka artikuj qe jane kerkuar dhe nuk dihet se cfare te sjellet p.sh eshte kerkuar moster per artikullin nr.69 Libreza për arme A5 32 faqe color ne kete rast ne nuk kemi asnje informate se si duket libreza per arme , cfare forme ka apo cka te shtypet ne at librez , se paku cka keni mundur te beni eshte dashur qe te ngarkoni nje foto ,nje dizajn grafik se si duket libreza per arme, ne nuk e din se as cka te shtypin ne ato 32 faqe te librezes pasi qe nuk ka nje model se si duket dhe si duhet te shtypet, artikulli nr.62 Lidhja e librave A3 sipas porosisë , 100 fleta lidhje e forte me kopërtina te forta dhe me mbishkrim – per kete artikull nuk dim se cka te sjellim si moster , cfare mbishkrimi te ket , a te sjelet liber a3 apo te behet pershkrimi i detajuar si behet lidhja e librave a3 apo te ofrohet lidhja e librave; artikulli nr.89 Shtypja e Mirënjohjeve për stafin A4 350gr – cka te sjellet si moster nuk kemi ndonje informat a te tregohet shtypja si behet apo cka pasi qe nuk ka specifikim teknike se cka duhet te sjellet , cfare forme apo si duket mirenjohjta per stafin.

Pretendimi 6

Neni 37 Mostrat e Tenderëve

37.1 Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u kërkohej të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni certifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

Andaj mostrat e kerkuara jane shume te pakjarta , ka mangesi ne pershkrim teknike, specifikimi teknik eshte i manget dhe i pa kuptushem per disa artikuj.

Pretendimi 7

Afatet Kohore

Gjithashtu shkelje tjetër e AK-se eshte edhe vendimi mbi kërkesën per rishqyrtim ku thot qe eshte e jashtë afatshme. Ne shume mire e dim qe bazuar ne nini 60 te rregullores pika a) kurdo qe kërkesa per rishqyrtim ka te beje me njoftimin per kontrat ose me dokumentet e tenderit se paku pese (5) dite para afatit te fundit te dorëzimi te ofertave. Ne kalkulim te afateve kohore dita e dorëzimit te ofertave eshte dita 0 , pra ftesat janë dërguar me datën 18.08.2026 ndersa hapja me datën 24.08.2026 – dita 0 -5 dite dhe kur llogaritetet afati AK-ja nuk ka lene me qellim afat per kerkes per rishqyrtim pasi e gjithë procedura eshte vetëm 5 dite dhe kur mund te behet kërkesa per rishqyrtim.

Ne baze te dëshmimeve te prezantuar me larte dhe legjislacionit ne fuqi qe e rregullon fushën e prokurimit publike ne Republikën e Kosovës shihet qarte se gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit AK nuk e ka respektuar asnjë nga dispozitat e LPP-se dhe legjislacionit sekondar te specifikuara me larte dhe ky veprim nga ana e AK-se përben një shkelje flagrante te legjislacionit për Prokurim.

Prandaj ne si operator ekonomik ankues, bazuar ne provat dhe dëshmitë e prezantuara si me sipër, kërkojmë nga OSHP, dhe zyrtaret përgjegjës te saje qe te gjitha këto shkelje te bëra nga ana e AK-se ti trajtoi te gjitha pretendimet tona ankimore ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre:

V E N D I M

- I. Te aprovohet** ne tërësi si e bazuar ankesa e OE NTSH OFFICE TRADE
- II. Te korrigohet procedura/dosja e tenderit se bashku me specifikimin teknike**, si i kundërligjshëm;
- III. Te obligohet** AK – **Ministria e Punëve te Brendshme**, qe këtë procedure te prokurimit ta kthej ne ri-tenderim dhe
- IV. Te lejohet** kthimi i mjeteve te deponuara ne emër te ankesës

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pergaditja e gabuar i AK-se se kesaj procedure na krijon kosto dhe marzhe te fitimit te humbur demtim fitimit eventual marzhes dhe imazhit duke na krijuar diskriminim. Shpenzime sa i perket pergaditjes e kerkese per rishqyrtim si dhe ankeses ne oshp dhe fitimit te parapare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*